



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PML.nr.200/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit S. T., nga fshati G. e E., Komuna e G. për shkak të veprës penale “*Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar*” nga neni 422, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.25/2021, të datës 09.10.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.708/23, të datës 25.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 15.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit S. T., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.25/2021, të datës 09.10.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.708/23, të datës 25.01.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.25/2021, të datës 09.10.2023, i dënuari S. T. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale “*Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar*” nga neni 422, paragrafi 1, të KPRK-së dhe ndaj tij është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 13.10.2014 e deri me datën 17.03.2015 dhe masën e arrestit shtëpiak nga data 17.03.2015 deri më 08.05.2015, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Është detyruar i dënuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, për aq sa janë përcaktuar sipas rregullores së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëqind (100) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50) euro. Po ashtu është detyruar që palës së dëmtuar, Komuna e Graçanicës t'ia paguaj dëmin në shumë prej 58.021.47 euro, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore, Gjykatës së Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.708/23, të datës 25.01.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit S. T., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit S. T., avokati Ramë Gashi nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 të KPP, lidhur me nenin 384, të KPP-së dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 432, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, lidhur me nenin 385 të KPRK-së, me propozimin që Gjykata Supreme e Kosovës t'a ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë, të dënuarin t'a liroj nga aktakuza, apo t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen penale ta kthen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.116/2024, e datës 27.03.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit S. T., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP, dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është kundërtë në vetvete dhe me arsyet e paraqitura në arsyetimin e aktgjykimit, me provat e administruara dhe shkresat e lëndës. Pastaj, aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë merren me shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale që lidhen me dispozitën e nenit 384, të KPP-së, kjo për faktet se aktgjykimet nuk paraqesin qartë dhe në mënyrë të plotë rrethanat se përse i konsiderojnë të vërtetuara faktet vendimtare, gjithashtu nuk vlerësojnë saktësinë e provave të administruara rreth vërtetimit të gjendjes faktike.

Në kërkesë pretendohet se dëshmitë e dëshmitarve: B. P. dhe I. M., për hirë të vërtetës nuk janë dëgjuar nga gjykata në seancën e rigjykimit, ashtu siç i kishte udhëzuar Gjykata e Apelit me aktvendimin e saj PAKR.nr. 417/2020 të datës 19.01.2021.

Po ashtu mbrojtësi i të dënuarit thekson se gjykatat e instancave më të ulta janë marrë edhe me shkeljen e ligjit penale nga neni 422 paragrafi 1, kinse i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, ndonëse në fakt i mbrojturi i tij ka punuar si punëtor depoist pa përshkrim të detyrave të punës dhe përgjegjësi, e jo si depoist kryesor, me çka tek i dënuari S., si në rastin konkret nuk gjendet asnjë nga atributet që parashikon dispozita ligjore si më lartë, e as që u provuar se i njëjti ka kryer këtë vepër penale.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, për faktin se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me

shkelje të ligjit penal, siç pretendohet në kërkesë, pa e cekur decidivisht se cila dispozitë ligjore nga neni 384 dhe 385.e KPP-së, është shkelur.

Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës, pas analizimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, nuk ka vërejtur ndonjë shkelje në këtë drejtim, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është në harmoni të plotë me arsyetimin, kurse në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë shihet qartë se janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat e aktgjykimit, ashtu siç është parashikuar në nenin 369, paragrafi 6 të KPP-së dhe se përshkrimet e dhëna në arsyetim, përmbajnë të gjitha arsyet për faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërthënëse.

Në këtë drejtim, nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet që janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh janë konsideruar të vërtetuara, si dhe janë paraqitur arsyet në të cilat, gjykata në fjalë është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprave penale dhe përgjegjësisë.

Siç rezulton nga shkresat e çështjes, gjegjësisht provat material të administruara në shqyrtimin gjyqësor, nuk është kontestuese fakti se i dënuari S. T. kishte themeluar marrdhëne pune, në Komunën e Graçanicës, në afat kohor sipas kontratave të lidhura dhe nënshkruara: të datës 01.08.2012, 31.07.2013, 01.08.2013 dhe kontratë së datës 31.07.2014, në pozitën e depoistit. I dënuari S. T., i punësuar në Komunën e Graçanicës-Sektori i Shëndetësisë në fshatin Ll., ka pasur cilësinë e përsosur përgjegjës në ruajtjen e mallit në depot përkatëse (aparaturat, paisjet sanitare dhe barna). Nga dëshmia e dëshmitarit B. P., si punëtor roje në departamentin për Shëndetësi dhe Politikë Sociale, dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, rezulton se përveç S., nuk kishte dikush tjetër çelsa të depon ku punonte ai, sipas të njejtës S. e kishte parë dy herë të hynte në depo pas orarit të punës me veturën e tij “...” për të marrë nga depoja paisje medicinale paketa me madhësi 50x50cm, të mbyllura dhe pa ndonjë mbishkrim, të cilit i kishte ndihmuar t’i bartë deri te vetura e tij, pastaj herën tjetër ka vërejtur se S., ka marrë nga depoja qese najloni të tejdukshme me fasha si dhe një paketim të ma dh. Po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit I. M., Dejtore i Shëndetësisë në Komunën e Graçanicës, vërtetohet se përgjegjës për tri depot në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë ishte S. T. sipas tij, para marrjes së detyrës, kishte dëgjuar se dy herë më parë ishin thyer depot. Ditën kritike, pasi që kishte dëgjuar se ishte thyer depoja, kishte njoftuar policinë, me të shkuar të policisë në vend ngjarje kishin konstatuar se nuk kishte thyerje fizike apo hapje me dhunë. Dëshmitari I. thekson se për rastin e dyshuar kishte themeluar një komision prej 3 anëtarëve, ku të njejtës fillimisht kishin thyer dryrin dhe kishin filluar regjistrimin e paisjeve që kishin ngelur në depo, ku sipas vlerësimit të komisionit, malli që mungonte kap shumën prej 58,021.47 euro.

Si rezultat i këtyre veprimeve, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka paraqitur arsyetime të mjaftueshme dhe të bazuara në prova, mbi bazën e të cilave është ardhur deri tek konkludimi se në këtë rast i dënuari S. T., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veti, ka ndërmarrë veprimet inkriminuese të cilat janë të përshkruara në mënyrë të hollësishme në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me çrast të dëmtuarës Komuna e Graçanicës i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm dhe ate 58,021.47 euro.

Gjithashtu, edhe nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë rezulton se janë vlerësuar të gjitha pretendimet e rëndësishme ankimore të mbrojtësve të të dënuarve dhe janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta sa i përket këtyre pretendimeve, por edhe sa i përket shkeljeve tjera për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, kështu që edhe në këtë drejtim, pretendimet e mbrojtjes rezultojnë të pabazuara.

Sa i përket pretendimit të mbrojtësit të të dënuarit se gjykata e shkallës së parë, gjatë trajtimit të kësaj çështje penale në rigjykim, dëshmitë e dëshmitarëve nuk janë dëgjuar fare, nuk qëndron për faktin se pretendime të njëjta mbrojtja ka paraqitur edhe përmes ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, e cila përkitazi me këtë pretendim ka dhënë arsye të mjaftueshme në aktgjykimin e atakuar me kërkesë, në faqe 7 pasusi i parë, ku theksohet se *”... në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 21.09.2023 në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues në lidhje me leximin e deklaratave të dëshmitarëve dhënë në seancën e mëparshme në këtë çështje penale, prokurori i shtetit ka deklaruar se propozon edhe pajtohet që të konstatohen të lexuara deklaratat e dëshmitarëve, si kundër që është deklaruar edhe përfaqësuesi i komunës së Graçanicës, kurse mbrojtësi i të pandehurit av. Ramë Gashi dhe i pandehuri S. T. kanë deklaruar se pajtohen që të konstatohen të lexuara këto deklaratat, andaj bazuar në propozimin e palëve për leximin e këtyre provave, trupi gjykues ka nxjerr aktvendim procedural me të cilin në bazë të nenit 335, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3 i KPP-së, ka konstatuar të lexuara deklaratat e dëshmitarëve I. M. dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 19.07.2016, si dhe deklarata e dëshmitarit B. P., e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 05.06.2015”*.

Po ashtu, pretendimet e mbrojtjes se i denuari, S. T., ka punuar në periudha kohore në komunën e Graçanicës vetëm si punëtor-depoist, e jo në cilësinë e depoistit kryesor, ku nuk ka asnjë nga atributet e keqperdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422, paragrafi 1 i KPRK-së, me çka janë bërë shkelje të ligjit penal ndaj të dënuarit, nuk është i bazuar për faktin se nga vet kontrata e punës vërtetohet se i denuari S. i punësuar në organin shtetror-Komunën e Graçanicës, rezulton se ka statusin e personit zyrtar në këtë çështje penale.

Duke u bazuar në nenin 422, paragrafi 1 të KPRK-së, vepra penale *“Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”*, konsiderohet se është kryer në momentin kur personi zyrtar, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër, pavarësisht faktit nëse është arritur që të realizohet përfitimi i çfarëdo dobie për kryesin (personin zyrtar) apo për personin tjetër apo pavarësisht faktit nëse është shkaktuar dëm për personin tjetër apo janë shkelur seriozisht të drejtat e personit tjetër.

Me këtë, rast vlen të theksohet se për dallim nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës i më parshëm, ky i vitit 2019, në nenin 113, paragrafi 2, jep një përkufizim më të detajuar për atë se kush mund të konsiderohet person zyrtar, megjithatë nuk ka ndonjë definicion të veçantë se kush mund të konsiderohet person zyrtar dhe se kjo duhet vlerësuar në çdo rast individualisht duke marrë parasysh natyrën e pozitës, funksionit dhe në theks të veçantë detyrave të kryera nga ai person.

Person zyrtar, mund të konsiderohet vetëm ai individ i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë (duke qenë i punësuar në institucionet publike) apo të tërthortë (personi i cili mund të ushtroj funksione jashtë institucioneve publike), kur të njëjtit i janë deleguar autorizime publike, menaxhimi i parasë publike apo ushtrimi faktik i detyrave-punëve zyrtare. Në momentin që menaxhon me të mira publike, nuk ka rëndësi pozita që e mban, me rëndësi është që i ka keqpërdor mjetet publike, respektivisht që ka keqpërdor autorizimet dhe detyrat apo punët zyrtare të cilat i ushtron në mënyrë faktike.

Përtej kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë, është përshkruar në mënyrë të hollësishme vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari S. T., së bashku me faktet dhe rrethanat që i përbëjnë figurat e veprave penale “*Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*”, nga neni 422, paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal.

Nga arsyet e cekura më lart dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.200/2024, më datë 15.05.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala